

**VENDIM**  
**Nr. 173, datë 31.7.2025**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË  
SHOQËRISË “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” SHPK PËR LICENCIM NË  
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2123/1 prot., datë 23.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Global Technical Mechanics’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.

konstatoi se:

- Shoqëria “Global Technical Mechanics” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2123 prot., datë 18.7.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

**Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren**

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.1, të Rregullores, aplikuesi ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit në përputhje me përcaktimet e aneksit A të Rregullores.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2, të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar. Për sa i përket germës “a”, shoqëria ka dorëzuar ekstraktin historik të regjistrit tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), të datës 9.7.2025, nga ku rezulton se është regjistruar më 29.3.2017, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.). Të dhënat për emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin përputhen me ato të paraqitura në aplikim. Për germën “b” janë paraqitur dëshmitë e penaltetit për subjektin dhe administratoren e tij, përmes dy vërtetimeve të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të datave 9.7.2025 dhe 10.7.2025, nga të cilat rezulton se si subjekti, ashtu edhe administratori nuk rezultojnë të dënuar.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2.4, të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike. Në zbatim të germës “a”, shoqëria ka paraqitur parashikimin e sasisë së energjisë elektrike që planifikon të furnizojë për 5 vjetët në vijim. Lidhur me germën “b”, shoqëria ka bërë të ditur se për operimin në veprimtarinë e furnizimit do të përdorë sisteme IT të përshtatshme për procesin e faturimit, duke përfshirë opsione të tilla si Financa 5 (aktualisht në përdorim), Tridens, Methodia, SkyBill, apo çdo sistem tjetër ekuivalent. Gjithashtu, objektet do të pajisen me sistemin SCADA për monitorim dhe kontroll. Në zbatim të germës “d”, shoqëria ka deklaruar se klientët do të furnizohen në nivelet e tensionit 20 kV, 35 kV, 110 kV dhe 220 kV dhe se realizimi i matjes për klientët do të bëhet përmes matësve të vendosur dhe të miratuar nga operatori i sistemit.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

## **Neni 9**

### **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

*Pika 1.1, "Formati i aplikimit, sipas përcaktimeve të shtojcës 1"*

- Shoqëria duhet të depozitojë shtojcën 1 të plotësuar në të gjithë zërat e saj.

*Pika 1.2, "Dokumentacioni juridik dhe administrativ"*

- Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse në lidhje me strukturën e saj, duke informuar dhe në lidhje me stafin që ka aktualisht efektiv (germa "c").

*Pika 1.3, "Dokumentacioni financiar dhe fiskal"*

Shoqëria duhet të depozitojë:

- Vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (germa "a").

- Dokumentacion vërtetues të disponimit të mbështetjes financiare për të garantuar ushtrimin e të paktën 1 (një) muaji veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (germa "b").

- Planin e biznesit të përditësuar (germa "c").

*Pika 2.4, "Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike"*

- Shoqëria duhet të informojë mbi mënyrën e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit (germa "c").

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

### **VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Global Technical Mechanics" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "Global Technical Mechanics" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**